REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**KËSHILLI I MINISTRAVE**
**KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

**VENDIM**

Nr.34, datë 18.10.2023

**PËR**
**MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:**
**"GREEN COAST RESORT 2, ZONA G8, HOTEL DHE NJËSI SHËRBIMI ME 1, 2, 3, 4 DHE 6 KATE MBI TOKË DHE 1 KAT NËNTOKË", ME VENDNDODHJE NË BASHKINË HIMARË**

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit", i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërinë "Seaside Hotel" sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: "Green Coast Resort 2, Zona G8, Hotel dhe njësi shërbimi 1, 2, 3, 4 dhe 6 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë", me vendndodhje në Bashkinë Himarë, me subjekt zhvillues shoqërinë "Seaside Hotel" sh.p.k.

2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.

3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
   a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
   b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Himarë.

4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë për Turizmit dhe Mjedisin, për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT - KËSHILLI I MINISTRAVE

**KRYETARI**

**EDI RAMA**

MINISTËR I LINJËS

**MINISTËR PËR TURIZMIN DHE MJEDISIN**

**MIRELA KUMBARO FURXHI**

SEKRETAR I KKT

**DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**

**ADELAJDA ROKA**

Nënshkruar më datë 08/10/2024